VENDIM
Nr.611, datë 1.10.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
"RADIO TOP ALBANIA"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.01/FMK, të rinovojë për një afat të ri 6-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Top Albania" sh.a.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 3.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)